



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 782/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.11.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-83755-08-24-2018, me objekt “*Paisja me orendi e 4 menceve në shkollat ku do të implementohet projekti “Bëjmë detyrat e shtëpisë”*”, me fond limit 5.380.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 11.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “M.Lezha” sh.p.k., “Ro-Al” sh.p.k. dhe “Erzeni/SH” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Bolt” sh.p.k.
Njësia Tregtare nr.3, Blloku “Gintash”, Laprakë, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia e Tiranës
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 27.08.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-83755-08-24-2018, me objekt “Paisja me orendi e 4 mencave në shkollat ku do të implementohet projekti “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, me fond limit 5.380.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 11.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.

II.2. Në datën 11.09.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitimin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 14.09.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--------------------------------|------------------------------|
| 1. “M.Lezha” sh.p.k. | 4.037.600 lekë, kualifikuar |
| 2. “Bolt” sh.p.k. | 4.099.000 lekë, skualifikuar |
| 3. “Dajti Construxion” sh.p.k. | 4.558.000 lekë, skualifikuar |
| 4. “Ro-Al” sh.p.k. | 4.678.800 lekë, kualifikuar |
| 5. “Erzeni/SH” sh.p.k. | 5.306.600 lekë, kualifikuar |

II.4. Në datën 14.09.2018, operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

“Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator Ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë: Autoriteti Kontraktor në dokumentat standart të tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/Kapaciteti Teknik në pikën 7 citohet: Operatori Ekonomik duhet të disponojë jo më pak se 2 (dy) mjete transporti me kapacitet mbajtës nga 2 ton deri ne 3.5 ton per secilin mjet. Operatori ekonomik ka deklaruar se zotëron mjetet e mëposhtëme:

1. Kamion me targë AA 627 HD. Kamioni me targë AA 627 HD vënë në dispozicion nga operatori ekonomik ka kapacitet mbajtës 1.2 Ton. Komisioni i vlerësimit të ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur për kamionin me targë AA 627 HD, gjykon se në mbështetje të akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi në lejen e qarkullimit referuar pesha, përfaqëson pesha kufitare të përgjithshme me ngarkesë të plotë të mjetit që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e ngarkesës së tij dhe referuar lejes së qarkullimit të mjetit ku pesha Bruto është 3500 kg ose 3.5 ton dhe pesha neto 2280 kg ose 2.28 ton vihet re se kapaciteti mbajtës është 1.2 ton. Pra sa më sipër cituar kapaciteti mbajtës apo ngarkesa e mjetit është: “Pesha kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plotë e mjetit - peshën e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje”

2. Kamion me targë TR 9167 T. Dokumentacioni për Kamionin me targë TR 9167 T të vënë në dispozicion nga Operatori Ekonomik, nuk është I plotë. Konkretisht mungon fleta shoqëruese e lejes së qarkullimit ku do të shihej nëse kapaciteti mbajtës është nga 2 ton deri ne 3.5 ton, sipas DST.

3. Kamion me targë AA279DK. Kamioni me targë AA279DK vënë në dispozicion nga operatori ekonomik është I rregullt. Përsa më sipër, Operatori Ekonomik nuk e ka përmbushur kërkesën e vendosur nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me makinerite ku kerkohen 2 (dy) mjete transporti me kapacitet mbajtës nga 2 ton deri ne 3.5 ton per secilin mjet. Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “Bolt” shpk, lidhur me pikën 7, mbi disponimin e mjeteve të transportit, është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreut VII, neni 66,

pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.”

II.5. Operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k. në datën 17.09.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit. Gjithashtu, operatori ekonomik ankimes ngre pretendime mbi operatorët e tjerë ekonomikë të kualifikuar. Konkretisht operatori ekonomik ankimes në ankesën e tij pretendon si më poshtë vijon:

[...]Nga Njoftimi ne portalin e App verejme qe oferta jone eshte refuzuar (arsyet e refuzimit bashkengjitur) si dhe verejme dhe kualifikimin e disa operatoreve te tjere ekonomik (bashkngjitur). Ne DST shtojca 8, 2. Kriteret e Vecanta te Kualifikimit pika 7 kerkohet: Operatori Ekonomik duhet te disponoje jo me pak se 2 (dy) mjete transport me kapacitet mbajtes nga 2 ton deri ne 3.5 ton per secilin mjet.

Per kete kerkese, duke ripare dhe njehere te gjithe dokumentat qe ne kemi hedhur ne system verejme qe ne kemi ngarkuar ne sistemin e APP tre makina Makinen me targe AA627 HD e cila nuk ploteson kerkesen e vendosur nga ju si Autoritet Kontraktor, por dy makina e tjera plotesojne dhe tejkalojne kapacitetin e vendosur duke e argumentuar dhe ne dokumentacion e paraqitur Me konkretisht per mjetin me targe TR 9167 T ne certifikaten e kontrollit teknik (SGS) pershkruhet kamione nga 3.5-7.5 tone, si dhe fleta e pare e lejes se qarkullimit, foto e mjetit, taksat et. Te cilat pasqyrojne sakte kete kerkese per kualifikim ne lidhje me kete mjet transport. (dokumentacioni i hedhur në sistem, bashkengjitur).

Gjithashtu sipas LPP Nr.9643, date 20.11.2006, ndryshuar, Neni 53 Shgyrtimi i ofertave Pika 4 “Autoriteti kontraktor vlereson nje oferte te vlefshme edhe nese ajo permban devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndryshojnd thelbesisht karakteristika, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si gabime shtypi, te cilat mund te korrigojohen pa prekur permbajtjen e saj (bashkangjitur fleta e lejes se qarkullimit).

Sic duket kjo flete nuk eshte vene re nga specialistet e KVO pa paragjykuar punen e tyre. Pra, si perfundim kete pike operatori Bolt e ka permbushur me sukses dhe si e tille oferta jone eshte e sukseshme. Gjithashtu ne pike 2.15 -Operatoret ekonomike duhet te paraqese mostra te cilat duhet te dorezohen ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave pane AK Lista e mostrave qe duhet te paraqiten sipas specifikimeve teknike te dhene ne DST, te jene: Tavoline ngrenie; Etazher i kuzhines se menses; Aksesore per kuzhine; Stol ngrenie.

Perfaqesuesit e firmes tone ne vendin e mostrave ne datën dhe oren e percaktuar kane vene re keto probleme ne lidhje me mostrat e paraqitura nga operatore ekonomik pjesmarres ne kete procedure prokurimi (foto bashkngjitur).

- Operatori ekonomik Ro-Al nuk ka paraqit mostrat sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne aneksin "Specifikimet teknike". Me konkretisht: 1- Etazheri nuk eshte ne ngiyren e kerkuar ne specifikimet teknik pasi ky operator ekonomik ka paraqitur nje pjese te etazherit me ngjyre te bardhe. (Foto Bashkangjitur). 2- Permasat e etazherit nuk jane sipas specifikimeve teknike te kerkuara tek aneksi “specifikimet teknik”, pasi gjatesia eshte afersisht sa 1/3 e etazherit te kerkuar, e cila do te sillte nje problem ne realizim e kontrates ne konceptimin e permasave (Foto Bashkangjitur). 3- Nuk ka paraqitur tavolinen e ngrenies sipas specifikimeve teknike te kerkuara tek aneksi “specifikimet teknik”. (Foto Bashkangjitur). 4- Nuk ka paraqitur stolin per

tavolinat sipas specifikimeve teknike te kerkuara tek aneksi "specifikimet teknik". (Foto Bashkangjitur). Keshtu qe ketij operatori Ekonomik i duhet refuzuar oferta.

- Operatori ekonomik M Lezha; nuk ka paraqit mostrat spas pikes 2.15 te DST dhe sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne aneksin "Specifikimet teknik". Me konkretisht: Permasat e etazherit nuk jane spas specifikimeve teknike te kerkuara tek aneksi "specifikimet teknik", pasi gjatesia eshte afersisht sa 1/3 e etazherit te kerkuar, si dhe mungon ndarja prej 15 cm ne pjesen e siperme. Te gjitha keto do te krijonin probleme ne realizimin e kontrates dhe ne perlllogaritjen e ofertes. (Foto Bashkangjitur) 2- Kembet e stolit nuk jane sipas ngiyres se kerkuar ne specifikimet teknik (Foto Bashkangjitur). 3.Mungon mostra "Aksesor kuzhine" sipas pikes 2.15 te DST. Keshtu qe ketij operatori ekonomik i duhet refuzuar oferta.
- Operatori ekonomik Erzeni: nuk ka paraqit mostrat sipas pikes 2.15 te DST dhe sipas specifikimeve teknike te kerkuara ne aneksin "Specifikimet teknik" Me konkretisht: 1.Permasat e etazherit nuk jane sipas specifikimeve teknik te kerkuara tek aneksi "specifikimet teknik", pasi gjatesia eshte afersisht sa 1/3 e etazherit te kerkuar, si dhe mungon ndarja prej 15 cm ne pjesen e siperme. Te gjitha keto do te krijonin probleme ne realizimin e kontrates dhe ne perlllogaritjen e ofertes. (Foto Bashkangjitur) 2.Kembet e stolit nuk jane sipas ngiyres se kerkuar ne specifikimet teknik (Foto Bashkangjitur) 3.Mungon mostra "Aksesor kuzhine" sipas pikes 2.15 te DST. Keshtu qe ketij operatori Ekonomik i duhej refuzuar oferta.

Pra si perfundim ne giykimin tone arrijme ne perfundimin qe nuk ka pasur nje kordinim te perfaqesuesve qe presin mostrat me perfaqesuesit e Komisionit te Vleresimit te Ofertave qe verifikojne dokumentacionin tekniko ligjor duke kualifikuar me te padrejte operatoret e mesiperm. Prandaj kerkojme riklasifikimin per kete procedure prokurimi dhe shpalljen fituese te ofertes sone.

II.6. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimes pranë KPP, ky i fundit pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me kthimin e përgjigjes se autoritetit kontraktor në datën 24.09.2018. Ndërkohë që, referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimes si dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, ky i fundit me anë të shkresës nr.34142/2 datë 20.09.2018, i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimes, duke e refuzuar atë. Ndër të tjera, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë vijon:

[...]Operatori Ekonomik "BOLT" shpk ne permbushje te kriterit te mesiperm, ne sistemin elektronik te APP-se ka deklaruar se disponon mjetet e meposhtme:

1. Kamion me targe AA627HD, ne pronesi te shoqerise "BOLT" shpk. Nga verifikimi i dokumentave ne sistemin elektronik te app-se rezulton qe kamioni me targe AA627HD, me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e qarkullimit eshte 1.2 ton. Ne mbeshtetje te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne lejen e qarkullimit referuar pesha, perfaqeson pesha kufitare te pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit qe perbehet nga pesha e vete mjetit te gatshem per levizje dhe nga ajo e ngarkeses se tij dhe referuar lejes se qarkullimit te mjetit ku pesha Bruto per mjetin me targe AA627HD eshte 3500 kg ose 3.5 ton dhe pesha neto 2280 kg ose 2.28 ton vihet re se kapaciteti mbajtes per mjetin me targe AA627HD eshte 1.2 ton.

2. Kamion me targe TR9167T, i siguruar me kontraten e qerases nr.2141 rep, 567 kol, date 06.07.2018, me qeradhenes z. Hiqmet Shehu.Nga verifikimi i dokumentave ne sistemin elektronik te APP-se rezulton qe dokumentacioni per Kamionin me targe TR9167T, nuk eshte i plote. Konkretisht mungon fleta shoqeruese e lejes se qarkullimit ku do te shihej nese kapaciteti mbajtes eshte nga 2 ton deri ne 3.5 ton, sipas DST. Komisioni i Vleresimit te Ofertave, verifikon dhe

vlereson vetem dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin elektronik te APP-se, deri ne daten e hapjes se ofertave e cila eshte data 11.09.2018. Nga verifikimi ne sistemin elektronik te APP-se, ky dokumentacion mungon. Operatori ekonomik ka kontestuar ne ankesen paraqitur prane Autoritetit Kontraktor arsyet e skualifikimit per te cilat pranon ne ankesen depozituar prej tij qe jane mangesi qe ekzistojne por qe nuk duhet te merreshin parasysh nga ana e KVO-se pasi jane devijime te vogla. Sqarojme se: Bazuar ne nenin 53, pika 4, te ligjit nr te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin Publik" I ndryshuar, percaktohet (cituat) [...]. Ne rastin konkret mjeti i kerkuar, me kapacitet mbajtes nga 2 ton deri ne 3.5 ton, eshte i lidhur ngushtesisht me realizimin faktik te kontrates. Mjeti i paraqitur me targe TR9167T, nuk eshte ne perputhje me kriterin specifik te vendosur ne DST, ne lidhje me kapacitetin mbajtes. Per mungese dokumentacioni, konkretisht fleta shoqeruese e lejes se qarkullimit, konkludojme se nuk kemi te bejme me devijim te vogel, por me mospermbushjen e nje kriteri thelbesor ne realizimin e kontrates.

3. Kamion me targe AA279DK, i siguruar me kontrate qeraje nr 2075 rep, 555 kol date 02.07.2018 me qeradhenes z. Kudret Mollaymeri. Nga verifikimi i dokumentave ne sistemin elektronik APP-se rezulton qe kamioni me targe AA279DK, me kapacitet mbajtes i cili del nga leja qarkullimit eshte 1.94 ton ("Pesha kufitare e pergjithshme me ngarkese te plote e mjetit - peshen e vete mjetit te gatshem per levizje). Konkretisht 7490-5550=1940 kg. Komisioni i Vleresimit te Ofertave, kamionin me targe AA279DK, e ka quajtur te rregullt. Komisioni i Vleresimit te Ofertave ne kete rast, i eshte permbajtur nenin 53, pika 4, te ligjit nr te ligjit nr. 9643, date 20. 11.2006 "Per prokurimin Publik" i ndryshuar dhe e ka quajtur si devijim të vogël. Sqarojme se kapaciteti mbajtes ne mbeshtetje te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne lejen e qarkullimit referuar Nr. 23 perfaqeson peshen kufitare te pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit qe perbehet nga pasha e vete mjetit te gatshem per levizje dhe nga ajo e ngarkeses se tij dhe referuar Nr. 24 te lejes se qarkullimit te mjetit duhet te paraqitet pesha e vete mjetit te gatshem per levizje. Pra sa me siper cituar kapaciteti mbajtes apo ngarkesa e mjetit eshte "Pesha kufitare e pergjithshme me ngarkese te plote e mjetit - peshen e vete mjetit te gatshem per levizje". Sqarojme se: Kriteret per kualifikim vendosen qe t'i sherbejne autoriteit kontraktor per njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve te operatoreve ekonomike, te cilet, nepermjet dokumentacionit te paraqitur duhet të vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknik, profesionale, kapacitetet organizative makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, gjithcka ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Kriteret kualifikuese te percaktuara nga autoriteti kontraktor jane te detyrueshme per tu permbushur nga te gjitha ofertuesit ekonomike pjesemarres ne nje procedure prokurimi dhe eshte detyre e operatoreve ekonomike te dorezojne oferten ne perputhje me dokumentat e tenderit dhe kerkesat e autoritetit kontraktor. Ne kete kuptim, referuar dispozitave ligjore Neni 46 pika 1 te ligjit nr. 9643, date 20/1.2006 "Per prokurimin Publik" i ndryshuar ku citohet [...]. Operoret ekonomike pjesemarres duhet te vertetojne se zoterojne reputacionin, besueshmerine pervojen e duhur dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten objekt prokurimi, si edhe jane te detyruar te pergatisin oferta, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit, ne menyre qe edhe vleresimi te behet ne perputhje me kete dokumentacion. Pjesemarrja e tij ne kete procedure dhe paraqitja e ofertes nga ana e shoqerise presupozon qe ka marre persiper te permbushe te gjitha kriteret qe Autoriteti Kontraktor i vlereson te nevojshme per sa kohe qe ato jane ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohen dhe jodiskriminuese. Keto kriteret te vendosura nga ana e Autoritet Kontraktor nuk jane kontestuar nga ana e operatorit

ekonomik pra janë konsideruar nga ana e këtij operatori si kritere në përputhje të plote me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi. Në nenin 53 pika 3 e ligjit Nr 9643 dr 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar) parashikohet [...]. Sa me sipër pretendimi i pales ankimuese në lidhje me plotësimin e kritereve të vecanta për kualifikim, pika 7, nuk qëndron pasi theksojmë edhe njëherë kamionat e paraqitur në sistemin elektronik të APP-se, nuk plotësojnë kriterin e kërkuar nga ana e AK-se.

Në lidhje me pikën 2

Autoriteti kontraktor, në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e vecanta të Kualifikimit, pika 2.15 "Operatorët ekonomikë duhet të paraqesë mostra të cilat duhet të dorëzohen në ditën dhe orën e hapjes së ofertave pranë AK". Në pari tek "Specifikimet teknik", bashkëngjitur DST, nuk është përcaktuar gjatësia e etazherit. Konkretisht në specifikime teknik thuhet: "Etazheri mbi banak do të jetë në formën e ekspozitori. Etazheri do të vendoset në lartësinë 31.5 cm nga supina e banakut dhe do të përbehet nga 2 raftë pa kapak të mbështetur mbi pjesën e poshtme dhe me kapje në mur. Elementet e etazherit do të jenë material melamine ngjyrë pana me trashësi 18 mm në të gjitha pjesët e dukshme. Shpina është e përbërë me melamin po ngjyrë pana me trashësi 16 mm me ngjyrë pana. Bashkimi I elementeve bëhet me vida të dimensioneve perkatëse, Për sa i përket pikës 2, në lidhje me ngjyren e kembeve të stoli. Në Specifikimet Teknikë, është përcaktuar shprehimisht: Për sa të fillojë prodhimi ngjyrat dhe aksesoret do të përcaktohen nga personi përgjegjës i caktuar nga investitori. Në lidhje me pikën 3, mungesa e "Aksesore kuzhine", ju sqarojmë se Aksesore kuzhine, janë dorëzat e banakut, mentesha, vida etj. Këto aksesore janë të lidhura ngushtesisht me objektin kryesor. Aksesori nuk mund të qëndrojë me vete dhe nuk funksionon me vete. Mungesa e tyre si mostra konsiderohet devijim i vogël. Edhe nëse do të merrej në konsideratë pretendimi mbi mostrat nga Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave, perseri pozitive e Operatorit Ekonomik ankimues "Bolt" shpk, nuk do të ndryshonte, pasi ai mbetet me statusin i S'kualifikuar. Sa me sipër pretendimi i pales ankimuese në lidhje me plotësimin e kritereve të vecanta për kualifikim, pika 2.15, nuk qëndron. Sa me sipër pretendimi juaj si pale ankimuese nuk qëndron dhe lihet në fuqi vendimi i Komisionit të Vlerësimit të ofertave për procedurën e prokurimit me objekt: "Paisja me orëdi e 4 menceve në shkollat ku do të implementohet projekti "Bejme detyrat e shtëpisë".

II.7. Në datën 25.09.2018 operatori ekonomik "Bolt" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor. Ndër të tjera operatori ekonomik ankimues ka shtuar:

Kemi paraqitur të gjithë dokumentacionin e duhur për makinën për të vertetuar që ajo ka peshën e duhur dhe kapacitetin, për të përmbushur këto pike që kërkohej në kërkesat për kualifikim, madje është paraqitur dokumentacion dhe një makine tjetër e cila përforcon dhe përmbush me se miri këto kërkesa kualifikuese. Me konkretisht janë paraqitur dokumenta për tre mjete transporti: Kamioni me targa AA627HD e cila ka dokumentacion të rregullt me peshe 1.2 Ton; Kamioni me targa AA279DK e cila ka dokumentacion të rregullt me peshe 1.940 Ton; Kamion me targa TR9167T për të cilin pretendohet nga AK që nuk ka dokumentacion të rregullt. Për këto mjet transport janë ngarkuar në sistem Kontrate qiraje, Taksat vjetore, certifikate regjistrimi, certifikate pronësie, kolaudim ku shenohet qartazi Kamione 3.5 deri 7.5 Ton, Sigurim mjeti, leje qarkullimi ku është hedhur vetëm fleta e parë (gabim njëzëror) si dhe foto mjeti.

Ne gjykimin tone ketu kemi te bejme me nje deviacion te vogel pasi eshte paraqitur fleta e pare e lejes se qarkullimit ku jane te pasqyruara dhe targa e mjetit te transportit, foto te mjetit, Certifikata e kontrollit Teknik (SGS) e cila cileson mjetin nga 3.5 deri ne 7.5 Ton. Bazuar kjo dhe ne LPP Nr. 9643, date 20. 11.2006, ndryshuar, Neni 53/4. Si përfundim këmbëngulim që pika 7 në kriteret e vecanta të kualifikimit është përmbushur, duke shtuar dhe faktin që ne kemi paraqitur dhe një mjet transporti me shume se sa kërkohej në këtë pikë.

Përsa i përket kualifikimit të operatorëve të tjerë ekonomikë në lidhje me mostrat, ne kriteret e vecanta të kualifikimit pika 2.15 -Operatoret ekonomike duhet te paraqese mostra te cila duhet te dorezohen ne ditën dhe oren e hapjes se ofertave pane AK Lista e mostrave qe duhet te paraqiten sipas specifikimeve teknike te dhene ne DST, te jene: Tavolinë ngrenie, Etazher I kuzhines së menzës, Aksesore per kuzhine, Stol ngrenie. Përsa I përket mostrave të paraqitura asnjë nga operatoret ekonomike nuk e ka përmbushur kete pike (foto te mostrave te operateve te tjere bashkangjitur), specifikimet e kerkuara nga autoriteti kontraktor (bashkangjitur) dhe preventivi me listen e produkteve sipas shkollave (bashkangjitur).

1-Asnje nga operatoret ekonomik nuk ka paraqitur etazherin sic kerkohet ne specifikimet teknik dhe me gjatesine e percaktuar sipas preventivit (kuzhine 9 m2). Preventivi per kuzhinen eshte paraqitur per m2 dhe cdo shkolle e ka kuzhinen 9 m2. Me konkretisht pjesa e poshtme eshte 90 cm dhe pjesa e sipërme eshte 90.5 cm e larte. Duke qene se siperfaqja e kerkuar eshte 9 m2 ne gjatesi lineare poshte dhe lart eshte 4.86 ml. Ne kerkesat per kualifikim per mostren e etazherit ne asnje rast nuk eshte kerkuar 1/3 apo cope por kerkohet Etazher i kuzhines se menses dhe llogjikshem me kete gjatesi lineare ne te kundert do te kishim nje precedent per realizimin e kontrates nga operatore e tjere ekonomik. Kjo gje justifikon dhe oferten me te ulet qe ka paraqitur operatori ekonomik M Lezha Shpk.

2- Persa I perket mostres Aksesore per kuzhine ne pergjigjen qe jep autoriteti kontraktor ne shkresen me nr 34142/2 Prot, Tirane me 20.09.2018, aksesore kuzhine jane dorezat e banakut, mentesha vida etj. mungesa e tyre eshte percaktuar si devijim I vogel. Por duke pare specifikimet e hedhura ne sistem per kuzhinen verejme qe kerkohet mekanizem kendor mekanizem U+0. doreza inoxi. Sqarojme se mekanizmat kendor variojne ne cmime tregu nga 200-800 Euro sipas markave dhe cilesive te ndryshme, te pershtatshme per funksionalitetin e kuzhines Kjo moster rrit shume koston e kuzhines dhe kerkohet detyrimisht ne preventive. Keshtu qe mos paraqitja e kesaj mostre kurrsesi nuk mund te jete nje devijacion I vogel, sic shprehet AK ne kthim pergjigje. Mos paraqitja e mostres ka sjelle dhe oferten me te ulet qe ka paraqitur operatori ekonomik M Lezha Shpk.

3- Ne lidhje m e mostren stol ngrenie ne specifikimet teknik kerkohet ngiyra e te gjithë elementeve do te jete bezhe me shkelqim, megjithate ne kendveshtrimin tone ku eshte nje devijacion I vogel dhe nuk mund te perbeje luhatje per cmimin e ofertes. Si përfundim mostrat nuk jane pare nga specialist te fushes (cka do ishte me normale mos te kerkoheshin fare)sepse ata do te kishin percaktuar sakte gabimet e mostrave duke pare specifikimet teknik te hedhura ne system. Prandaj te njejten gje qe kerkuam tek Autoriteti Kontraktor kerkojme shpalljen fituese te ofertes sone dhe skualifikimin e ofertave te tjera ne lidhje me mostrat e paraqitura.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 36234/1 prot., datë 05.10.2018, protokolluar me tonën në datën 08.10.2018, me objekt “Dërgim dokumentacioni në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Pajisja me orendi e 4 menceve në shkollat ku do të implementohet projekti “Bëjmë detyrat e shtëpisë” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i

autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit të tij “Kamioni me targë AA 627 HD vënë në dispozicion nga operatori ekonomik ka kapacitet mbajtës 1.2 Ton. Komisioni i vleresimit të ofertave pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur për kamionin me targë AA 627 HD, gjykon se në mbështetje të akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi në lejen e qarkullimit referuar pesha, përfaqeson pesha kufitare të përgjithshme me ngarkesë të plote të mjetit që përbëhet nga pesha e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje dhe nga ajo e ngarkesës së tij dhe referuar lejes së qarkullimit të mjetit ku pesha Bruto është 3500 kg ose 3.5 ton dhe pesha neto 2280 kg ose 2.28 ton vihet re se kapaciteti mbajtës është 1.2 ton. Pra sa më sipër cituar kapaciteti mbajtës apo ngarkesa e mjetit është: “Pesha kufitare e përgjithshme me ngarkesë të plote e mjetit - peshën e vetë mjetit të gatshëm për lëvizje”. 2. Kamion me targë TR 9167 T. Dokumentacioni për Kamionin me targë TR 9167 T të vënë në dispozicion nga Operatori Ekonomik, nuk është I plotë. Konkretisht mungon fleta shoqëruese e lejes së qarkullimit ku do të shihej nëse kapaciteti mbajtës është nga 2 ton deri në 3.5 ton, sipas DST. 3. Kamion me targë AA279DK. Kamioni me targë AA279DK vënë në dispozicion nga operatori ekonomik është I rregullt. Përsa më sipër, Operatori Ekonomik nuk e ka përmbushur kërkesën e vendosur nga Autoriteti Kontraktor në lidhje me makineritë ku kerkohen 2 (dy) mjete transporti me kapacitet mbajtës nga 2 ton deri në 3.5 ton për secilin mjet. Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “Bolt” shpk, lidhur me pikën 7, mbi disponimin e mjeteve të transportit, është i paplotë, për rrjedhojë i pavlefshëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.” nuk qëndrojnë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 7 e “Kapacitetit teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

“7.Operatori Ekonomik duhet të disponojë jo më pak se 2 (dy) mjete transporti me kapacitet mbajtës nga 2 ton deri në 3.5 ton për secilin mjet.

Mjetet e transportit mund të jenë në pronësi ose me qera.

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikata e pronësisë së mjetit, siguracioni i mjetit, si dhe taksat vjetore.

- b) *Për mjetet e siguruara me qera, kontrata perkatese e qerase, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurim, dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), certifikata e pronësisë së mjetit, siguracioni i mjetit, si dhe taksat vjetore.*
- c) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet të deklaruar.*
- e) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tirane. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).*
- f) *Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzojë do të jenë sipas specifikimeve teknike.”*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k., për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë AA627HD, në emër të shoqërisë ”Bolt” sh.p.k..
 - Leje qarkullimi
 - Certifikatë e kontrollit teknik
 - Siguracionin e mjetit
 - Foto e mjetit
- Kontratë Qeraje Nr.2075 rep., Nr. 555 kol/3., datë 02.07.2018, për marrjen me qera të mjetit Kamion, me targë AA279DK, ndërmjet qeradhënësit Z.K.M dhe qeramarrësit shoqëria ”Bolt” sh.p.k.
 - Certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor AA279DK, në emër të Z.K.M.
 - Leje qarkullimi
 - Certifikatë e kontrollit teknik
 - Siguracionin e mjetit
 - Foto e mjetit
- Kontratë Qeraje Nr.2141 rep., Nr. 567 kol., datë 06.07.2018, për marrjen me qera të mjetit Kamion, me targë TR9167T, ndërmjet qeradhënësit Z.H.Sh dhe qeramarrësit shoqëria ”Bolt” sh.p.k.
 - Certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor TR9167T, në emër të Z. H.Sh.
 - Leje qarkullimi (vetëm fleta e parë)
 - Certifikatë e kontrollit teknik
 - Siguracionin e mjetit
 - Foto e mjetit

III.1.3. Operatori ekonomik ankimues pretendon: *Kemi paraqitur te gjithë dokumentacionin e duhur per makinen per te vertetuar qe ajo ka peshen e duhur dhe kapacitetin, per te permbushur kete pike qe kerkohet ne kerkesat per kualifikim, madje eshte paraqitur dokumentacion dhe nje makine tjeter e cila perforcon dhe permbush me se miri kete kerkese kualifikuese. Me konkretisht jane paraqitur dokumenta per tre mjete transporti: Kamioni me targa AA627HD e cila ka dokumentacion te rregullt me peshe 1.2 Ton; Kamioni me targa AA279DK e cila ka dokumentacion*

te rregullt me peshe 1.940 Ton; Kamion me targa TR9167T per te cilin pretendohet nga AK qe nuk ka dokumentacion te rregullt. Per kete mjet transport jane ngarkuar ne sistem Kontrate qiraje, Taksat vjetore, certifikate regjistrimi, certifikate pronesia, kolaudim ku shenohet qartazi Kamione 3.5 deri 7.5 Ton, Siguracion mjeti, leje qarkullimi ku eshte hedhur vetem fleta e pare (gabim njerezor) si dhe foto mjeti.

Ne giykimin tone ketu kemi te bejme me nje deviacion te vogel pasi eshte paraqitur fleta e pare e lejes se qarkullimit ku jane te pasqyruara dhe targa e mjetit te transportit, foto te mjetit, Certifikata e kontollit Teknik (SGS) e cila cileson mjetin nga 3.5 deri ne 7.5 Ton. Bazuar kjo dhe ne LPP Nr. 9643, date 20. 11.2006, ndryshuar, Neni 53/4. Si përfundim këmbëngulim që pika 7 në kriteret e vecanta të kualifikimit është përmbushur, duke shtuar dhe faktin që ne kemi paraqitur dhe një mjet transporti me shume se sa kërkohet në këtë pikë.

III.1.4. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues argumenton se: [...]Operatori Ekonomik "BOLT" shpk ne permbushje te kriterit te mesiperm, ne sistemin elektronik te APP-se ka deklaruar se disponon mjetet e meposhtme:

1. Kamion me targe AA627HD, ne pronesi te shoqerise "BOLT" shpk. Nga verifikimi i dokumentave ne sistemin elektronik te app-se rezulton qe kamioni me targe AA627HD, me kapacitet mbajtes i cili del nga leja e qarkullimit eshte 1.2 ton. Ne mbeshtetje te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne lejen e qarkullimit referuar pesha, perfaqeson pesha kufitare te pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit qe perbehet nga pesha e vete mjetit te gatshem per levizje dhe nga ajo e ngarkeses se tij dhe referuar lejes se qarkullimit te mjetit ku pesha Bruto per mjetin me targe AA627HD eshte 3500 kg ose 3.5 ton dhe pesha neto 2280 kg ose 2.28 ton vihet re se kapaciteti mbajtes per mjetin me targe AA627HD eshte 1.2 ton.

2. Kamion me targe TR9167T, i siguruar me kontraten e qerese nr.2141 rep, 567 kol, date 06.07.2018, me qeradhenes z. Hiqmet Shehu. Nga verifikimi i dokumentave ne sistemin elektronik te APP-se rezulton qe dokumentacioni per Kamionin me targe TR9167T, nuk eshte i plote. Konkretisht mungon fleta shoqeruese e lejes se qarkullimit ku do te shihej nese kapaciteti mbajtes eshte nga 2 ton deri ne 3.5 ton, sipas DST. Komisioni i Vleresimit te Ofertave, verifikon dhe vlereson vetem dokumentacionin e ngarkuar ne sistemin elektronik te APP-se, deri ne daten e hapjes se ofertave e cila eshte data 11.09.2018. Nga verifikimi ne sistemin elektronik te APP-se, ky dokumentacion mungon. Operatori ekonomik ka kontestuar ne ankesen paraqitur prane Autoritetit Kontraktor arsyet e skualifikimit per te cilat pranon ne ankesen depozituar prej tij qe jane mangesi qe ekzistojne por qe nuk duhet te merreshin parasysh nga ana e KVO-se pasi jane devijime te vogla. Sqarojme se: Bazuar ne nenin 53, pika 4, te ligjit nr te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin Publik" I ndryshuar, percaktohet (citur) [...]. Ne rastin konkret mjeti i kerkuar, me kapacitet mbajtes nga 2 ton deri ne 3.5 ton, eshte i lidhur ngushtesisht me realizimin faktik te kontrates. Mjeti i paraqitur me targe TR9167T, nuk eshte ne perputhje me kriterin specifik te vendosur ne DST, ne lidhje me kapacitetin mbajtes. Per mungese dokumentacioni, konkretisht fleta shoqeruese e lejes se qarkullimit, konkludojme se nuk kemi te bejme me devijim te vogel, por me mospermbushjen e nje kriteri thelbesor ne realizimin e kontrates.

3. Kamion me targe AA279DK, i siguruar me kontrate qeraje nr 2075 rep, 555 kol date 02.07.2018 me qeradhenes z. Kudret Mollaymeri. Nga verifikimi i dokumentave ne sistemin elektronik APP-se rezulton qe kamioni me targe AA279DK, me kapacitet mbajtes i cili del nga leja qarkullimit eshte 1.94 ton ("Pesha kufitare e pergjithshme me ngarkese te plote e mjetit - peshen e vete mjetit te gatshem per levizje). Konkretisht 7490-5550=1940 kg. Komisioni i Vleresimit te Ofertave,

kamionin me targe AA279DK, e ka quajtur te rregullt. Komisioni i Vleresimit te Ofertave ne kete rast, i eshte permbajtur nenit 53, pika 4, te ligjit nr te ligjit nr. 9643, date 20. 11.2006 "Per prokurimin Publik" i ndryshuar dhe e ka quajtur si devijim të vogël. Sqarojme se kapaciteti mbajtes ne mbeshtetje te akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne lejen e qarkullimit referuar Nr. 23 perfaqeson peshen kufitare te pergjithshme me ngarkese te plote te mjetit qe perbehet nga pasha e vete mjetit te gatshem per levizje dhe nga ajo e ngarkeses se tij dhe referuar Nr. 24 te lejes se qarkullimit te mjetit duhet te paraqitet pesha e vete mjetit te gatshem per levizje. Pra sa me siper cituar kapaciteti mbajtes apo ngarkesa e mjetit eshte "Pesha kufitare e pergjithshme me ngarkese te plote e mjetit - peshen e vete mjetit te gatshem per levizje".

III.1.5. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”

III.1.6. Në nenin 28, pika 5/ç të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.1.7. Ndërsa në nenin 27 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm me anë të të cilit të vërtetojnë se disponojnë jo më pak se dy mjete transporti me kapacitet mbajtës nga 2 ton deri në 3.5 ton për secilin mjet.

Në verifikim të përmbushjes së kriterit për mjetet e kërkuara, që është edhe arsyeja e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, rezulton se, operatori ekonomik “Bolt” sh.p.k. për këtë kriter ka paraqitur Certifikatën e pronësisë së mjetit me targë AA627HD, në emër të shoqërisë ”Bolt” sh.p.k. shoqëruar me dokumentacionin për këtë mjet, Kontratën e Qerasë Nr.2075 rep., Nr. 555 kol/3., datë 02.07.2018, për marrjen me qera të mjetit Kamion, me targë AA279DK, shoqëruar me dokumentacionin për këtë mjet, si dhe Kontratën e Qerasë Nr.2141 rep., Nr. 567 kol., datë 06.07.2018, për marrjen me qera të mjetit Kamion, me targë TR9167T, shoqëruar me dokumentacionin për këtë mjet.

Referuar arsyes së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues si dhe pretendimeve të këtij të fundit, nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, konkretisht, për mjetin me targë AA627HD, i paraqitur nga ky i fundit në përmbushje të kriterit për mjetet, referuar lejes së qarkullimit, rezulton se, ka një kapacitet mbajtës më pak se 2 ton, pra më pak se sa kërkohet në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor. Akoma më tej, vetë operatori ekonomik ankimues në ankesën pranë autoritetit kontraktor dhe në ankesën pranë KPP, pranon që ky mjet nuk plotëson kapacitetin e kërkuar, konkretisht operatori ekonomik shprehet *”...Makina me targë AA627HD e cila nuk plotëson kërkesën e vendosur nga ju si autoritet kontraktor...[...]...Kamion me targa AA627HD e cila ka dokumentacion të rregullt me peshë1.2 Ton...[...]”*. Pra ky mjet nuk plotëson kapacitetin mbajtës nga 2 deri në 3.5 ton të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Për sa i përket mjetit me targë TR9167T, që operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi, në përmbushje të kriterit të mësipërm, KPP nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike, konstaton se, ashtu sic autoriteti kontraktor është shprehur në arsyet e skualifikimit për këtë operator, dokumentacioni për këtë mjet nuk është paraqitur i plotë, pasi mungon një nga faqet e lejes së qarkullimit, si një nga dokumentat e domosdoshëm që duhet të dorëzohet për mjetet e paraqitura, kërkuar shprehimisht në dokumentat e tenderit. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur të plotë lejen e qarkullimit për mjetin me targë TR9167T, dhe për këtë arsye nuk mund të verifikohet kapaciteti mbajtës i këtij mjeti, fakt ky i pranuar edhe nga vetë operatori ekonomik ankimues. Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Për më tepër, autoriteti kontraktor ka përcaktuar qartësisht në dokumentat e tenderit, se cilat dokumenta duhen paraqitur me qëllim vërtetimin e disponimit të mjeteve të transportit. Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga ana e ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, objekt shqyrtimi, nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

III.1.8. Gjithashtu, KPP sqaron se, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori

ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues “Bolt” sh.p.k., nuk plotëson kërkesën e vendosur nga autoriteti kontraktor, në dokumentat e tenderit, për sa i përket kriterit në lidhje me disponimin minimumi të dy mjeteve të transportit me kapacitet mbajtës nga 2 ton deri në 3.5 ton për secilin mjet.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k. për skualifikimin e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit, konkretisht operatorët ekonomikë “M.Lezha” sh.p.k., “Ro-Al” sh.p.k. dhe “Erzeni/SH” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.2.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (përkundrejt atij imagjinar) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Në rastin konkret, KPP sqaron se, referuar arsyesimit të mësipërm në pikën III.1. të këtij vendimi, duke qenë se gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k. mbetet e skualifikuar, rrjedhimisht ky operator ekonomik nuk legjitimohet të paraqesë ankesë për operatorët e tjerë ekonomikë, për sa kohë rezulton i skualifikuar nga procedura e mësipërme e prokurimit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bolt” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-83755-08-24-2018, me objekt “Paisja me orendi e 4 mence në shkollat ku do të implementohet projekti ”Bëjmë detyrat e shtëpisë”, me fond limit 5.380.500 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 11.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia e Tiranës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1530 Protokolli

Datë 25.09.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

